



HARTA E PROBLEMATIKAVE VENDORE NË 6 NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË **DURRËS**


Mars 2022



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

www.PerQytetin.com

❖❖ CFARË ËSHTË NISMA ❖❖ “PËR QYTETIN”?

Një konsorciumi organizatash të udhëhequra nga Qëndresa Qytetare e cila synon të risë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen e Këshillave Bashkiake Tiranë, Durrës dhe Kurbin duke fuqizuar qytetarët, organizatat dhe grupet e interesit për të të luajtur një rol aktiv në përcaktimin e përparësive zhvillimore të komunitetit dhe territorit ku ato banojnë apo punojnë duke ndërmarrë peticione dhe iniciativa elektronike. Kjo nismë mbështetet nga Lëviz Albania dhe SDC në Shqipëri.



Në thelb të kësaj nisme e është nxitja e ushtrimit të të drejtave ligjore të parashikuara në nenin 19 dhe 20 të ligjit 139/2015 për Vetqeverisjen Vendore të cilat garantojnë zbatimin e detyrimeve ligjore të bashkisë dhe rrisin cilësinë e qeverisjes. Gjithashtu demokracia vendore pasurohet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesit në qeverisjen vendore dhe më së pari mundësohet nga qeverisja e mirë vendore.

Për Qytetin Vendos ti

Ne synojmë nxitjen dhe forcimin e demokracisë vendore dhe inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Bashkisë, si dhe në influencimin e axhendën qeverisëse të Bashkisë.

❖❖ SI JANË MBLEDHUR TË DHËNAT E ❖❖ HARTËZUARA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE?

Qëndresa Qytetare zhvilloi një pyetësor në 3 bashkitë e përfshira në këtë nismë, **Tiranë, Durrës dhe Kurbin** ku u pyetën **600 qytetarë**. Intervistuesit u lokalizuan në të gjitha njësitë administrative të bashkive për të komunikuar me banorët mbi problematikat që ata hasin. Të dhënat u mbledhën në rrugë digjitale, u përpunuan dhe u paraqitën në formën e hartës e cila shoqëron këtë material.

Ekipi i Qëndresës realizoi një verifikim faktesh të dytë duke fotografuar nga afër një pjesë të problematikave që shprehën banorët e këtyre njësive administrative.



❖❖ KUJT I SHËRMBEN HARTA E ❖❖ PROBLEMATIKAVE VENDORE?

Harta e problematikave vendore

Së pari: i shërben Këshillave Bashkiake dhe administratës së 3 bashkive për t'u njohur me shqetësimet e banorëve sipas zonave të tyre dhe për t'i adresuar ato kryesisht, bazuar në detyrat dhe funksionet që u jep ligji për vetqeverisjen vendore.

Së dyti: harta i shërben organeve vendore për të ndërtuar planet strategjike, për të organizuar dëgjesat publike dhe buxhetin vendor.

Së treti: kjo hartë i shërben organizatave pjesë e konsorciumit dhe grupimeve të tjera qytetare për të ngritur në nivel advokimi dhe lobimi fushatat e tyre për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e fokusit drejt problemeve të qytetarëve. Gjithashtu harta do të jetë një pikënisje për petitionet dhe iniciativat që do të drejtohen Këshillave Bashkiake nga organizatat pjesë të këtij konsorciumi.

◆◆ BASHKIA E DURRËSIT

Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrimit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil është 680 banorë km².



◆◆ CFARË MENDOJNË BANORËT PËR PETICIONET DREJTUAR KËSHILLIT BASHKIAK?

Pyetësi u krye në 3 qytete të ndryshme të Shqipërisë me kërkesë të Qëndres "Qëndresa Qytetare" ku në vëmendje kishte problematikat e 3 bashkive të vendit: Bashkia Kurbin, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës.

Pyetësi kishte pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura ku në të mund të bashkërendoheshin të dhëna sasiore dhe të dhëna cilësore, në këtë mënyrë mund të ndërtohen rezultate sa më objektive dhe ku mund të kishte një gërshetim të variablave të varur dhe të pavarur. Kampionimi rastësor ka qënë në vëmendje të hartimit, mbledhjes të të dhënave, respektimin e barazisë gjinore dhe raportimin.

Qendra "Durrësi Aktiv" është angazhuar për mbledhjen e të dhënave në terren duke respektuar privacinë e të dhënave dhe janë informuar të gjithë individët të cilët kanë marrë pjesë në intervistim. Para se të merreshin të dhënat subjektet janë siguruar se të dhënat e grumbulluara nëpërmjet këtij pyetësi do të ruajë karakterin e tyre konfidencial dhe në asnjë rast nuk do të lejohen të identifikohen direkt ose indirekt, plotësimi i saktë ndihmon në grumbullimin e informacionit për një gjykim më të drejtë mbi problematikat e Bashkisë së Durrësit. Marrja e të dhënave ka qënë rastësor është kryer me devotshmëri nga ekspertët e qendrës duke respektuar etikën profesionale dhe mendimin e të intervistuarit, duke mos u imponuar në përgjigjet e dhëna.

Janë marrë në intervistë 200 individë me profesione, arsim, punësim të ndryshëm për të marrë opinione sa më të ndryshme dhe rastësi në përzgjedhjen e personave, 53% e personave të intervistuar ishin burra dhe 43% e të intervistuarve ishin gra. Janë kryer intervista në 6 rajone të ndryshme në qytetin e Durrësit. Grup-moshat që morën pjesë në intervistë 44% ishin 15-29, 30-49 ishin 34% dhe 50-60 ishin 22% që u përgjigjën pyetësorit.

ISHËM

1. Ndotja e lumenjve/detit.
2. Punësimi.
3. Furnizimi me uje.
4. Ndrichiimi dhe infrastruktura rrugore.



SUKTH

1. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore.
2. Ndrichiimi i lagjeve dhe rrugëve.
3. Ngrohja nëpër shkolla.
4. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.
5. Punësimi.



DURRËS

1. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.
2. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore.
3. Trajtimi i ujrave të ndotur.
4. Ndrichiimi i lagjeve dhe rrugëve.



MANZË

1. Furnizimi me ujë.
2. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore.
3. Ndrichiimi i lagjeve dhe rrugëve.
4. Punësimi.



KATUND I RI

1. Rehabilitimi i sistemeve kulluese.
2. Ndrichiimi i lagjeve dhe rrugëve.
3. Transporti publik vendor.
4. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.



RASHBULL

1. Rehabilitimi i sistemeve kulluese.
2. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore.
3. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.
4. Punësimi.
5. Furnizimi me ujë.



Njësia Administrative Durrës, përfshihen 5 rajone të qytetit të Durrësit dhe është njësia administrative, sipas burimeve zyrtare kjo njësi administrative më e rëndësishme për nga ana social-ekonomike dhe nga numri dhe dendësia e popullimit. Rreth 121 individë u përgjigjën ose 60% e personave që morën pjesë në pyetësorë. Sipas përgjigjeve të marra janë nxjerrë keto rezultate rreth problematikave kryesore në qytet:

1. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.
2. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore. (Vitet e fundit ka pasur investime në rrugët kryesore por ka lënë pa mirëmbajtje akset e tjera rrugore).
3. Trajtimi i ujrave të ndotur. (Zonat kryesore 1 dhe 5 derdhen në det ujërat e papërpunuara duke sjellë ndotjen e bregdetit dhe duke qënë burim infeksionesh për pushuesit).
4. Ndrëçimi i lagjeve dhe rrugëve. (Janë lënë disa zona të rajoneve 3,4,5 pa ndrëçimin e përshtatshëm).

Cit. nga banorët ... Ndotja me plehra ne cdo lagje te Durrësit është bërë problem sepse kazanet nuk pastrohen në kohe duke bërë që të tejmbushen...

Cit. nga banorët ... Ndrëçimi i paket i disa lagjeve dhe rrugeve te Durrësit, sidomos i lagjeve 13, 15, 17,18,5...



Njësia Administrative Ishëm, është nga njësitë më të skajshme të Bashkisë së Durrësit, e karakterizuar nga një reliev kodrinor i cili ndonjëherë përshkrimi i kësaj zone është i vështirë me mjete motorrike dhe largësia me qytetin e Durrësit ka sjellë një realitet socio-ekonomik ndryshe nga njësitë administrative. Në të kemi kryer rreth 11 intervista, njësia administrative e Ishmit ka një popullsi relativisht të ulët. Sipas përgjigjeve të marra kemi konstatuar këto problematika:

1. Ndotja e lumenjve/detit. (lumi i Ishmit i cili sipas agjensive për monitorimin e lumenjve dhe ndotjen e mjedisit përbën dhe lumin më të ndotur në Evropë).
2. Punësimi. (Duke qënë njësia më e largët administrative ka sjellë dhe vështirësi në zhvillimin socio-ekonomik të kësaj zone, pjesa më madhe e familjeve mbahen me dërgesat në para të emigrantëve).
3. Furnizimi me uje.
4. Ndrëçimi dhe infrastruktura rrugore.

Cit. nga banorët ... Lumi Ishëm sjellë mbetje...

Cit. nga banorët ... Punësimi është shumë keq nuk hapen më vende pune...



Njësia Administrative Manëz. Kjo njësia administrative ka një popullsi prej 12083 dhe 3223 familje, pjesa më e madhe e banorëve mbahen me blegtori dhe bujqësi, dërgimin e të ardhurave nga emigracioni dhe nga punësimi në biznese të ndryshme. Në Manëz u përgjigjën 13 individë të cilët janë 6% e numrit të të intervistuarve. Problematikat kryesore në këtë zonë janë:

1. Furnizimi me ujë (familje të tëra ankohen se nuk kanë furnizim të rregullt me ujë të pijshëm).
2. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore. (Rrugët kryesore janë të shtruara por rrugët dytësore nuk janë të asfaltuara).
3. Ndrëçimi i lagjeve dhe rrugëve. (Një pjesë e rrugëve kryesore janë të ndrëçuara ndërsa rruget e tjera dytësore janë të pa ndrëçuara).
4. Punësimi.



Njësia Administrative Sukth. Përbëhet 7846 familje dhe është një nga njësitë më të mëdha administrative e cila ka dalje në rrugën kryesore interurbane Durrës-Tiranë. Zona ka si burim kryesor ekonomik bujqësinë. Janë përgjigjur rreth 14 individë ose 7% të të anketuarve, problematikat kryesore janë:

1. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore. (Rrugët dytësore janë të amortizuara dhe kanë mungesë të sinjalistikës rrugore).
2. Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve. (Një pjesë e rrugëve kryesore janë të ndriçuara ndërsa rrugët e tjera dytësore janë të pa ndriçuara).
3. Ngrohja nëpër shkolla.
4. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.
5. Punësimi.

Cit. nga banorët... Sinjalistikat rrugore nuk ekzistojne fare. Eshte fakt i njohur ndotja e lumit erzen dhe grykderdhja e ketij lumi.

Cit. nga banorët... Gjithashtu nevojitet forcimi i hapësirave kulturore. Krijimi i qendrave rinore në funksion real të të rinjve



Njësia Administrative Katund i Ri. Kjo njësi administrative ka një popullsi prej 16182 banoresh, pjesa më e madhe e banorëve mbahen me blegtori dhe bujqësi. Në Katund të Ri u përgjigjën 27 individë të cilët janë 13% e numrit të të intervistuarve. Problematikat kryesore në këtë zonë janë:

1. Rehabilitimi i sistemeve kulluese.
2. Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve. (Një pjesë e rrugëve kryesore janë të ndriçuara ndërsa rrugët e tjera dytësore janë të pa ndriçuara).
3. Transporti publik vendor. (Linjat e autobuzëve janë të kufizuara dhe përbën problem për banorët duke u kufizuar në pritjen me orare te gjata.
4. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.

Cit. nga banorët ...Prej vitesh, pas 1000 premtimeve, kjo rruge eshte e pashtruar. Kjo shoqerohet pastaj me mungesen e ndricimit, si edhe me mungesen e transportit.

Cit. nga banorët... Rehabilitimi i sistemeve kulluese mbetet një problematikë shqetësuese përgjatë dimrit për një pjesë të madhe të familjeve në njësinë ku banoj...

Cit. nga banorët... Gjithashtu nevojitet forcimi i hapësirave kulturore.



Njësia Administrative Rashbull. Kjo njësi administrative ka një popullsi prej 33685 banoresh, pjesa më e madhe e banorëve mbahen me blegtori dhe bujqësi, Në Rashbull u përgjigjën 27 individë. Problematikat kryesore në këtë zonë janë:

1. Rehabilitimi i sistemeve kulluese. (mundësi të mira për bujqësi por kanë problem me furnizimin me ujë dhe kanalet vaditëse janë zënë nga mbeturinat dhe ndërtimet abuzive).
2. Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore. (Rrugët dytësore janë të amortizuara dhe kanë mungesë të sinjalistikës rrugore).
3. Largimi dhe trajtimi i mbetjeve.
4. Punësimi.
5. Furnizimi me ujë. (Zona familje të tëra ankohen se nuk kanë furnizim të rregullt me ujë të pijshëm).

Cit. nga banorët... Sistemet kulluese janë të bllokuara si dhe shpesh herë ndodh që mbetjet të mos largohen në vende të caktuara...

Cit. nga banorët... Ka problem me gjendjen ekonomike...





Për Qytetin *Vendos ti*

QytetarIN RRETH NESH PETICIONI INICIATIVA QYTETARE KESHILLI BASHKIAK AKTIVITETE

MERR PJESË NË PETICION

RRITJA E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

PETICIONI/ INICIATIVA Elektronike

Demokracia digjitale në nivel vendor [www.p...](#)

Watch Later Share

Watch on YouTube

ANËTARËT
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONET
KESHILLI BASHKIAK

VENDIMET
KESHILLI BASHKIAK

LIGJ NR. 139/2015 PËR VETEQEVERISJEN VENDORE

LAJMI I FUNDIT

Qëndresa Qytetare dhe Durrësi Aktiv nismë të përbashkët Për Qytetin

Peticione/ Iniciativa të realizuara

Peticion/ Iniciativa Aktive

Nis një Peticion ose Initiative

Shkarko Aplikacionin

Google Play

HARTA E PROBLEMATIKAVE DHE NEVOJAVE EMERGJENTE PËR NDERHYRJE NË NIVEL VENDOR

www.perqytetin.com



Nis një peticion ose Iniciativë

*Tu mungojnë shërbimet dhe infrastruktura në lagjen tuaj?
Doni të propozoni një akt që sjell ndryshim në bashkinë tuaj?
Besoni se keni mbështetjen e komuniteti që ju rrethon?
Qëndresa Qytetare ju inkurajon t'i drejtoheni Këshillit Bashkiak me Peticione dhe Iniciativa Qytetare për çështje që ju shqetësojnë dhe që lidhen me qytetin ku banoni*

Për Qytetin *Vendos ti*

Për Qytetin



Qëndresa
Qytetare



SYC
SEBASTIA YOUTH CENTER



DURRËS
AKTIV

Financuar nga LevizAlbania



LEVIZ
Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC